

Aneksi 1

POZICIONI GJEOGRAFIK

Dhënien me koncesion për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto Romano, Durrës.


Zona e individualizuar për ndërtimin e fushës së bovave MBM ndodhet, në afërsi të bregdetit shqiptar mbi 2,500m nga linja bregdetare në afërsi të Porto Romano-s, Durrës brenda koordinatave:

Pika A: N- 41° 22'18.532"
E- 19°23'31.052"

Pika B: N- 41° 21'48.277"
E- 19°23'46.517"

Pika C: N- 41°21'36.625"
E- 19°23'6.361"

Pika D: N- 41°22'6.877"
E- 19°22'50.891"



Pjesa e dytë është pjesa e impiantit në distributorin shpërndarës. Distributori shpërndarës shërben për lidhjen e operatoreve të ndryshëm që duan të shfrytëzojnë Sistemin e Ankorimit të Llojit MBM ndodhet në koordinatat:

Pika "P1" N- 41°22'32.520";
E- 19°25'19.200".

Për të kryer operacionet në tokë duhet një sipërfaqe toke prej 3,850 m². Kjo sipërfaqe është paralele me rrugën ekzistuese për në Romano Porto me distance 12 ml nga aksi i saj, për të mos penguar edhe zgjerimin në perspektive të kësaj pjesë të rrugës. Sipërfaqja e nevojshme është në formë paralelogrami me gjatësi mesatare 77 ml dhe gjerësi 50 ml dhe me sipërfaqe 3,850 m². Brenda këtij sheshi duhet të ndërtohet një godinë e cila do të shërbejë si stacion pompimi, zyra të nevojshme si edhe ambiente të tjera të nevojshme për operimin.

Pjesa e tretë janë tubacionet të cilat do të jenë me gjatësi totale mbi 2.500 metra dhe do të lidhin fushën e bovave (pjesa e parë) dhe distributorin shpërndarës në tokë (pjesa e dytë).

Në rastin specifik parashikohen tre tubacione prej çeliku i veshur (gunitato), nga të cilat dy tubacione 120 mm dhe një i tretë 200 mm, të pajisur në mënyrë të duhur me kundër

Kontratë Koncensionimi i formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës

tub për kontrollin e temperaturës. Këto tubacione mund të përdoren për transportin e Diezel, Benzine, Mazut, Solar, Naphta, Biokarburant, Bitum, Naftë Bruto.

Tubacioni që do të shërbejë për transportimin e Bitumit dhe Naftës Bruto duhet të përmbushë standardet në fuqi.